



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2045/1 Prot.

Tiranë, më 21.06.2023

URDHËR

Nr. 87, datë 21.06.2023

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR EKSPERTËT E JASHTËM QË DO TË
ANGAZHOHEN NË PROCESIN E PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË
APLIKANTËVE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK
2023-2024**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë...”, Statutin e UMT, Urdhrin nr.86, datë 13.6.2023 “Për ngritjen e komisionit të monitorimit dhe grupit teknik të punës për pranimet e kandidatëve që aplikojnë në programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2023-2024” të Rektorit të UMT-së, si dhe në shkresën nr. 204 prot, datë 20.6.2023 të Drejtorisë së Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, Rektorati i UMT,

URDHËROJ

I. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve si dhe dokumentacioni përkatës për ekspertët e jashtëm që do të angazhohen në procesin e përllogaritjes së pikëve dhe renditjes së aplikantëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2023-2024, janë si më poshtë:

I. Ekspert i programimit:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e shkencave informatike ose të aplikuara;
2. Të njohë ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
3. Të njohë kurrikulën e re dhe të vjetër të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë;
4. Të ketë eksperiencë në përllogaritjen e pikëve të kandidatëve që kanë aplikuar në institucionet e arsimit të lartë;
5. Të ketë njohuri të avancuara në fushën e programimit.

II. Ekspert i përpunimit të të dhënave excel i avancuar:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e shkencave informatike ose të aplikuara;

2. Të njohë ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
3. Të njohë kurrikulën e re dhe të vjetër të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë;
4. Të ketë eksperiencë në përlllogaritjen e pikëve të kandidatëve që kanë aplikuar në institucionet e arsimit të lartë;
5. Të ketë njohuri të avancuara të programit Excel, në përdorimin e funksioneve të kërkimit, funksioneve logjike dhe të përputhjes (Match/Vlookup/index) si dhe gjenerimi të raporteve PIVOT.

Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kërkesë me shkrim;
 2. Jetëshkrim sipas formatit standard (europass);
 3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për secilin program përkatës studimi);
 5. Dokument që vërteton eksperiencën në përlllogaritjen e pikëve si edhe të programeve sipas pikës 4 dhe 5 të kriterëve në pikën I dhe II.
- III. Kandidatët e interesuar të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Sektorin e protokoll-arkivës në Rektoratin e UMT ose nëpërmjet postës në adresën: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005 Tiranë.
- IV. Afati i dorëzimit të dokumenteve do të jenë nga data 22.6.2023 deri më 29.6.2023.
- V. Mënyra e vlerësimit: përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje.
- VI. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sektori i Burimeve Njerëzore dhe IT për publikimin e tij në faqen zyrtare të UMT.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

REKTORI
ARBEN GJATA

